



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I  
PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING**

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO  
CADASTRAL AGENCY**

<b>DATË/A/E</b>	<b>25 Janar, 2016</b>
<b>PËR/ZA/TO</b>	<b>Gjeodetët e licencuar me kualifikim shkollë e mesme</b>
<b>NGA/OD/FROM</b>	<b>Agjencia Kadastrale e Kosovës</b>
<b>LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT</b>	<b>Informatë rreth licencimit të gjeodetëve me kualifikim shkollë e mesme</b>

Sipas Nenit 11, Pika 5 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2013 licencat për gjeodetë me kualifikim shkollë e mesme kanë përfunduar me datë 24 janar 2016 dhe të njejtëve pas kësaj date nuk do u pranohen kërkesat për licencim. Agjencia Kadastrale e Kosovës si autoritet përgjegjëse për licencimin e kompanive dhe gjeodetëve për kryerjen e matjeve vendos si vijonë:

Prej datës 1 shkurt 2016 deri me datë 12 shkurt 2016 gjeodetët e licencuar me kualifikim shkollë e mesme do i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit në fushat e rradhitura më poshtë;

- Rregullativa ligjore e kadastrit
- Matjet Kadastrale
- Pjesa grafike (Harta Kadastrale)
- Pjesa tekstuale (SIKTK)
- KOPOS
- Katalogu për Matje Kadastrale dhe Korniza e Punës Nr. 2013/1 dhe Korniza e punës Nr. 2013/2

Trajnimi do të ketë karakter vlerësues dhe vetëm pas certifikimit të gjeodetëve të njejtit do të jenë të kualifikuar për aplikim për licencim. Kjo nënkupton se kërkesës për licencim duhet bashkëngjitur edhe certifikata për trajnimin e kryer me sukses.

Trajnimi do të mbahet në ambientet e AKK-së, tre ditë në javë, në dy grupe.

Grupi i parë i gjeodetëve do të trajnohet prej orës 09:00 deri më 11:00 ndërsa grupi i dytë i gjeodetëve do të trajnohet prej orës 13:00 deri më 15:00.  
Pjesëmarrësin në Grupin I dhe Grupin II si dhe detaje tjera teknike do të definohen ditëve në vijim dhe për të njëjtit do të informoheni me kohë.

**Me rëndësi:**

Trajnimit mund të i nënshtrohen gjeodetët për vazhdim të licencës por edhe ata që deri më sot nuk kanë aplikuar për licencim. Gjeodetët me shkollë të mesme që nuk kanë aplikuar më parë për licencimn lutem që të kontaktojnë AKK-në përmes postës elektronike [akk@rks.gov.net](mailto:akk@rks.gov.net) për evidentim për trajnim.